



Prishtinë, 07.10.2021  
Kodi i ZRRE-së: V\_1429\_2021

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2225\_09\_21** i dt.06.09.2021;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **23.09.2021**;

në seancën e mbajtur më datë 07.10.2021 nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin A.LL nga Komuna e Besianës, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK\_V\_2225\_09\_21, i datës 06.09.2021.

### A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 06.09.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK\_V\_2225\_09\_21 me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit A.LL dhe e ka obliguar ndërmarrjen KESCO që ta anulojë korrigjimin plotësues nr. 94977DPR – 73981 të dt. 12.11.2019 në vlerë financiare prej 88.55 EUR.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- KESCO konsideron se korrigjimi i dt. 12.11.2019 është në përputhshmëri të plotë me rregullat në fuqi, pasi që nëse energjia e shpenzuar nga konsumatori nuk është regjistruar e tëra në njehsorin elektrik, si pasojë e djegies së një nga tri sistemet matëse, atëherë pjesa e mbetur e energjisë së shpenzuar, është përmirësuar përmes korrigjimit të faturave për 6 muajt e fundit të faturimit;
- ZRrE vendimin e saj e mbështet vetëm në krahasimin e shpenzimeve para dhe pas periudhës kontestuese;
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK\_V\_2225\_09\_21 i datës 06.09.2021 për konsumatorin A.LL.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 07.10.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin se korigjimi shtesë është në përputhshmëri me rregullat në fuqi, Bordi i ZRrE-së si të tillë e vlerëson si të paqëndrueshëm, për faktin se, pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, dhe në veçanti pas analizimit të Rrjedhës së Energjisë Elektrike, për periudhën para kontestit me njehsorin e vjetër elektrik nr. 9247601 dhe me njehsorin e ri elektrik nr. 53859337 për periudhën pas kontestit, Bordi i ZRrE-së ka konstatuar se nuk ka ndryshim të shpenzimeve, përkatësisht nuk ka rritje të shpenzimit. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike, mesatarja e shpenzimeve me njehsorin elektrik nr. 9247601 për periudhën 11/2017 deri në periudhën 07/2019 është **536 kWh/muaj** kurse me njehsorin e ri elektrik nr. 53859337 periudha 07/2019 deri në periudhën 11/2021 është **555 kWh/muaj**. Bordi ka analizuar edhe rrjedhën e energjisë për periudhën kontestuese për të cilën KESCO ka bërë korigjimin plotësues, periudhën 04/2019 deri në periudhën 09/2019 ku mesatarja mujore e shpenzimeve është **564 kWh/muaj** si dhe me njehsorin e ri nr. 53859337 për periudhën 04/2020 deri në periudhën 09/2020 dhe se mesatarja e shpenzimeve mujore është **541 kWh/muaj** me çka edhe **vërtetohet se konsumatori nuk ka ndryshim të shpenzimit të energjisë elektrike** e cila do të vërtetonte se njehsori elektrik nuk ka bërë matje të saktë për çka edhe është ngarkuar me korigjimin plotësues.

Po ashtu, duke u bazuar në analizën e përgjithshme si dhe në analizimin e listave të leximit me njehsorin e vjetër elektrik si dhe njehsorin e ri elektrik **konstatohet se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore.**

Në kundërshtimin e parashtruar ndaj vendimit kontestues, i vetmi argument të cilin i licencuari KESCO e ka paraqitur rreth këtij rasti, është Procesverbali i kontrollimit detal të njehsorit elektrik i dt. 28.10.2019, me të cilin është konstatuar se, për shkak se, sistemi i fazës T është i djegur, njehsori elektrik regjistron energji elektrike për 33% më pak, Bordi i ZRrE-së thekson se, si i tillë ky argument nuk është i mjaftueshëm për ta ngarkuar konsumatorin me korigjimin shtesë, për faktin se, konsumatori ka pasur lexim dhe faturim të rregullt, e edhe shpenzimi i energjisë elektrike, para dhe pas periudhës kontestuese, me dy njehsorë të ndryshëm elektrik, është vërejtur se, nuk ka ndryshim në shpenzim të energjisë elektrike e cila do të reflektonte mos matjen e saktë prej +33%.

ZRrE sqaron se në nenin 5, paragrafi 3, nënparagrafi 3.9, të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, thuhet se: *“sigurojë lexim të saktë dhe të rregullt të njehsorëve”*, në nenit 26 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, thuhet se: *“Operatori i Sistemit mund t’ia besojë leximin e njehsorëve furnizuesve ose ndonjë kontraktuesi tjetër. Në këtë rast, Operatori i Sistemit mbetet përgjegjës për të siguruar lexim të saktë dhe të rregullt dhe do të sigurojë që entiteti i kontraktuar për leximin e njehsorëve, do të bëjë lexim të rregullt dhe të saktë të njehsorëve, në përputhje me Kodin përkatës të Matjes. Operatori i Sistemit duhet të krijoj dhe paraqes procedurën për lexim të njehsorëve të konsumatorëve në Rregullator për shqyrtim dhe miratim”*; si dhe në nenin 28, paragrafi 1, të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, thuhet se: *“Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar e dhe për tarifën tjetër, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme)”*. Pra, duke u bazuar në dispozitat e sipërshënuara, Bordi



konstaton se, është në përgjegjësi të OSSh-së që të sigurojë lexim të saktë dhe të rregullt të njehsorëve, që në rastin konkret, ndërmarrja KEDS ka vepruar në harmoni me obligimet e tij ligjore. Me t'u vërejtur defekti/prishja në njehsorin elektrik, i njëjti është ndërruar, në harmoni me rregullat dhe procedurat në fuqi. Sikur prishja/defekti i njehsorit të vazhdonte për një kohë më të gjatë, i njëjti me patjetër do të reflektohej në shpenzimin e energjisë elektrike. Siç edhe u tha më lart, shpenzimi i energjisë elektrike, me njehsorin e ri, rezulton të jetë përafërsisht i ngjashëm si edhe me njehsorin e vjetër. Andaj, duke u bazuar në elaborimin e provave si më sipër, konstatojmë se, vendimi i shkallës së parë në ZRRE – Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve është vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 07.10.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së,
- Konsumatorit A.LI dhe,
- Arkivit të ZRRE-së

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Lutfije Dervishi, anëtare

\_\_\_\_\_  
Gani Buçaj, anëtar